

LIGJI I DATËS 22 MAJ 1975, nr. 152 (*Gazeta Zyrtare, nr. 136, e datës 24 / 05 / 1975*)
DISPOZITA NË MBROJTJE TË RENDIT PUBLIK.

Emri i burimit uniform: urn:nir:shteti:ligji:1975-05-22; 152

Hyrje

*DHOMA E DEPUTETËVE DHE SENATI I REPUBLIKËS KANË MIRATUAR:
PRESIDENTI I REPUBLIKËS*

SHPALL

KËTË LIGJ:

NENI 1

PËR VEPRAT PENALE QË JANË KRYER PAS: HYRJES NË FUQI TË KËTIJ LIGJI, LIRIA E PËRKOHSHE NUK PRANOHET NË LIDHJE ME VRASJEN ME DASHJE, TË KONSUMUAR OSE TË MBETUR NË TENTATIVË, TË PARASHIKUAR NGA NENI 575 I KODIT PENAL, ATENTATIT KUNDËR PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, TË PARASHIKUAR NGA NENI 276 I KODIT PENAL, ATENTATIT KUNDËR KUSHTETUTËS SË SHTETIT, TË PARASHIKUAR NGA NENI 283 TË KODIT PENAL, KRYENGRITJES SË ARMATOSUR KUNDËR PUSHTETEVE TË SHTETIT, TË PARASHIKUAR NGA NENI 284 I KODIT PENAL, SHKATËRRIMIT, BASTISJES OSE MASAKRËS, TË PARASHIKUARA NGA NENI 285 I KODIT PENAL, LUFTËS CIVILE, TË PARASHIKUAR NGA NENI 286 I KODIT PENAL, FORMIMIT DHE PJESËMARRJES NË BANDË TË ARMATOSUR, TË PARASHIKUARA NGA NENI 306 I KODIT PENAL, MASAKRËS SË PARASHIKUAR NGA NENI 422 I KODIT PENAL, KATASTROFË HEKURUDHORE, TË PARASHIKUARA NGA NENI 430 I KODIT PENAL, RREZIKUT TË KATASTROFËS HEKURUDHORE, TË PARASHIKUARA NGA NENI 431 I KODIT PENAL, ATENTATEVE KUNDËR SIGURISË SË TRANSPORTEVE, TË PARASHIKUARA NGA PJESA E PARË DHE NGA PARAGRAFI I DYTË I NENIT 432 TË KODIT PENAL, EPIDEMISË SË PARASHIKUAR NGA NENI 438 I KODIT PENAL, HELMIMIT TË UJËRAVE OSE TË LËNDËVE USHQIMORE, TË PARASHIKUAR NGA NENI 439 TË KODIT PENAL, GRABITJES ME KUSHTE RËNDUESE, TË PARASHIKUAR NGA PARAGRAFI I DYTË I NENIT 628 TË KODIT PENAL, ZHVATJE PARASH ME KUSHTE TË RËNDUARA, TË PARASHIKUAR NGA PARAGRAFI I NENIT 629 TË KODIT PENAL, RRËMBIM TË PERSONAVE, TË PARASHIKUAR NGA NENET 605 DHE 630 TË KODIT PENAL, KRIMEVE TË PARASHIKUARA NGA NENET 1 DHE 2 TË LIGJIT TË DATËS 20 QERSHOR 1952, NR. 645, SI EDHE ÇFARËDOLLOJ KRIMI QË KANË TË BËJNË ME ARMËT LUFTARAKE, TË TIPIT LUFTARAK OSE ME LËNDËT PLASËSE.

GJITHMONË PËR VEPRAT PENALE QË JANË KRYER PAS HYRJES NË FUQI TË KËTIJ LIGJI, LIRIA E PËRKOHSHE GJITHASHTU NUK MUND TË JEPET:

a) NË QOFTË SE I PANDEHURI I KRIMIT PËR TË CILIN ËSHTË I DETYRUESHËM MANDATI I ARRESTIMIT, ËSHTË NË GJENDJE LIRIE TË PËRKOHSHME, QË I ËSHTË DHËNË ATIJ NGA NJË PROCEDIM TJETËR, PËR NJË VEPËR PENALE QË SJELL PËR PASOJË SHPALLJEN E DETYRUESHME TË MANDATIT TË ARRESTIMIT;

a) NË QOFTË SE I PANDEHURI I NJËRIT PREJ KRIMEVE QË PARASHIKOHEN NGA NENET 582, PARAGRAFI I PARË, 583, 588, PARAGRAFI I DYTË, SI EDHE 610, TË KODIT PENAL, I NËNSHTROHET NJË TJETËR PROCEDIMI PENAL, PËR SHKELJEN E NJËRËS APO DISA DISPOZITAVE TË SIPËRËRMENDURA TË LIGJIT.

NË DHËNIEN E LIRISË SË PËRKOHSHME, NË RASTET NË TË CILAT LEJOHET, GJYQTATI ÇMON SE NUK KA SI PENGESË ARSYE TË PROCESIT GJYQËSOR, DHE AS EKZISTON MUNDËSIA, NË LIDHJE ME RËNDESËN E VEPRËS PENALE, SI EDHE NGA PERSONALITETI I TË PANDEHURIT, QË KY, MBASI TË JETË LËNË I LIRË, TË MUNDË TË KRYEJË SËRISH VEPRRA PENALE QË VËNË NË RREZIK NEVOJAT PËR MBROJTJE TË SHOQËRISË.

EDHE NË RASTET E PARASHIKUARA NGA PARAGRAFI I PARË DHE I DYTË, MUND TË JEPET LIRIA E PËRKOHSHME NË QOFTË SE BËHET FJALË PËR PERSON QË NDODHET NË KUSHTE SHËNDETËSORE VEÇANËRISHT TË RËNDA, TË CILAT NUK I LEJOJNË MJEKIMET E NEVOJSHME NË GJENDJEN E BURGIMIT.

NENI 2.

NË QOFTË SE KOHËZGJATJA MAKSIMALE E PARABURGIMIT MBARON NË TERMAT E PARASHIKUARA NGA NENI 1 I LIGJIT 07 TETOR 1969, NR. 742, OSE SIDOQOFTË ËSHTË PRANË MBARIMIT, GJYQTARI, ME URDHËRESË TË MOTIVUAR, TË PAKUNDËRSHTUESHME, E DEKLARON URGJENT PROCESIN, NË KËTË RAST, AFATET E PROCESIT GJYQËSOR FILLOJNË, EDHE NË PERIUdhËN E PUSHIMEVE, QË NGA DATA E NJOFTIMIT TË URDHËRESËS, NË TË NJËJTËN MËNYRË, EDHE AFATET E PROCESIT GJYQËSOR FILLOJNË QË NGA DATA KUR I PANDEHURI DHE AVOKATI MBROJTËS KANË DEKLARUAR SE HEQIN DORË NGA PEZULLIMI I VEPRIMTARISË GJYQËSORE.

NENI 3.

NENI 238 I KODIT TË PROCEDURËS PENALE, ËSHTË ZËVENDËSUAR NGA SA VIJON: EDHE JASHTË RASTEVE TË FLAGRANCËS, KUR EKZISTON DYSHIMI I BAZUAR PËR ARRATISJE, OFICERËT DHE AGJENTËT E POLICISË GJYQËSORE OSE TË FORCËS PUBLIKE MUND T'I NDALOJNË PERSONAT, KUNDREJT TË CILËVE EKZISTOJNË ELEMENTË PROVASH TË MJAFTUESHËM TË KRIMIT, PËR TË CILIN

LIGJI PËRCAKTON NJË DËNIM JO MË TË ULËT NË MAKSIMUMIN 6 (GJASHTË) VJET BURGIM, OSE TË KRIMIT QË KA TË BËJË ME ARMËT LUFTARAKE OSE TË TIPIT LUFTARAK, PUSHKËT ME QYTË TË SHKURTËR, MUNICIONET QË JANË TË DESTINUARA PËR ARMËT E SIPËRËRMENDURA, OSE LËNDËT SHPËRTHYESE, OFICERËT MUND TË MBAJNË TË NDALUARIT PËR KOHËN MË TË SHKURTËR TË NEVOJSHME PËR VERIFIKIMET E PARA, MBAS SË CILAVE DUHET T'I SHPIEN PERSONAT E NDALUARA MENJËHERË NË BURGJET GJYQËSORE OSE NË ATO TË QARKUT, NË QOFTË SE NË KËTO TË FUNDIT EKZISTON QELIA E IZOLIMIT. OFICERI I POLICISË GJYQËSORE QË KA KRYER NDALIMIN, OSE TË CILIT I ËSHTË PARAQITUR I NDALUARI, DUHET TË NJOFTOJË MENJËHERË PËR TË, DUKE TREGUAR DITËN DHE ORËN NË TË CILËN ËSHTË KRYER NDALIMI, PROKURORIN E REPUBLIKËS OSE NËSE NDALIMI NDODH JASHTË SELISË SË ZAKONSHME TË GJYKATËS, GJYQTARIT TË SHKALLËS SË PARË TË VENDIT KU AI ËSHTË KRYER.

PO AI OFICER I POLICISË GJYQËSORE, NË 48 ORËT QË NGA NDALIMI, DUHET T'I KOMUNIKOJË TË NJËJTIT AUTORITET GJYQËSOR ARSYET PËR TË CILAT ËSHTË URDHËRUAR NDALIMIN, SË BASHKU ME REZULTATET E HETIMEVE TË PËRMBLEDHURA QË JANË KRYER DERI NË ATË KOHË.

PROKURORI I REPUBLIKËS OSE GJYQTARI I SHKALLËS SË PARË, DUHET TË MARRIN MENJËHERË MASAT PËR MARRJEN NË PYETJE TË PERSONIT TË NDALUAR DHE, NË QOFTË SE E NJEH NDALIMIN SI TË MBËSHTETUR, E MIRATON NDALIMIN ME NJË DEKRET TË MOTIVUAR, MË E SHUMTA DERI NË 48 (DYZET E TETË) ORËT E MËPASME, QË NGA MARRJA E KOMUNIKIMIT TË DEKRETIT TË MIRATIMIT DHE MBASI I ËSHTË BËRË KOMUNIKIMI PERSONIT TË INTERESUAR.

NË ÇDO RAST, PROKURORI I REPUBLIKËS OSE GJYQTARI I SHKALLËS SË PARË, MBASI SIDOQOFTË KANË MARRË DIJENI PËR NDALIMIN, MERR MASAT NË ÇDO MOMENT, NË RAST SE E SHIKON MUNDËSINË, PËR HETIMET E POLICISË GJYQËSORE, NË MBËSHTETJE TË NENEVE 231 DHE 232.

DISPOZITAT E KËTIJ NENI ZBATOHEN EDHE PËR KRIMET E PARASHIKUARA NGA NENET 1, 2 DHE 4, TË LIGJIT TË DATËS 20 QERSHOR 1952, NR. 645, SI EDHE NGA NDRYSHIMET E MËVONSHME.

VAZHDON TË ZBATOHET DISPOZITA E NENIT 7 TË LIGJIT TË DATËS 14 TETOR 1974, NR. 497.

NENI 4.

NË RASTE TË JASHTËZAKONSHME NEVOJE DHE URGJENCE, NUK LEJOJNË MARRJEN E NJË MASE TË MENJËHERSHME TË AUTORITETIT GJYQËSOR, OFICERËT DHE AGJENTËT E POLICISË GJYQËSORE DHE TË FORCËS PUBLIKE,

GJATË ZHVILLIMIT TË OPERACIONIT TË POLICISË, MUND TË PROCEDOJNË, PËRVEÇ IDENTIFIKIMIT, EDHE ME KONTROLLIMIN E MENJËHERSHËM NË VEND, ME QËLLIMIN E VETËM PËR TË VERIFIKUAR ZOTËRIMIN E MUNDSHËM TË ARMËVE, TË LËNDËVE PLASËSE DHE TË MJETEVE THYERËSE, NGA PERSONA, QËNDRIMI I SË CILAVE OSE PRANIA E SË CILAVE, NË LIDHJE ME RRETHANA SPECIFIKE DHE KONKRETE, VENDI DHE KOHE, NUK DUKEN TË JUSTIFIKUESHME.

NË RASTIN E PARASHIKUAR NGA PARAGRAFI I MËSIPËRM, KONTROLLIMET MUND TË SHTRIHET, PËR TË NJËJTAT QËLLIME, EDHE MBI MJETIN E TRANSPORTIT QË ËSHTË PËRDORUR NGA PERSONAT E SIPËRPMENDURA PËR TË ARRITUR NË VEND.

PËR KONTROLLIMET E PARASHIKUARA NËPARAGRAFËT E MËPARSHËM, DUHET TË HARTOHET NJË PROCESVERBAL, NË NJË FORMULAR TË POSAÇËM, I CILI PËRCILLET, BRENTA 48 (DYZET E TETË) ORËSH, PROKURORIT TË REPUBLIKËS DHE, NË RASTIN E PARASHIKUAR NGA PARAGRAFI I PARË, I DORËZOHET TË INTERESUARIT.